



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:144220

Datë: 24.03.2022

Numri i dokumentit: 02839476

**PKR.nr.271/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova dhe gjyqtarët Sami Sharraxhia dhe Shaqë Curri anëtar, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve V. S, A. S dhe V. M. S nga M, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substanca psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg 2 lidhur me nenin 275 prg 1 pika 1.8 të KPRK-se, e sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/I.nr.225/20 të dt. 25.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarve V. S dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Muharrem Shala, i akuzuari A. S dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Lulzim Balaj, e akuzuara V. M. S dhe mbrojtësi i saj sipas detyrës zyrtare av. Haki Mavraj, me dt.17.03.2022 mori dhe shpalli me datë 24.03.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuari:**

**1.V. S**, i biri i R dhe nenës A e gjinisë M, i lindur me dt..... në M, me banim në rrugën “ N. M “ p.nr. i martuar, ka të kryer shkollën mesme, i pa punë, me nume personal ..... , i gjendjes së dobëte ekonomike, shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

**2.A. S**, i biri i R dhe nenës A e gjinisë M, i lindur me dt. .... në M, me banim në rrugën “ N. M “ p.nr. i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me nume personal ..... , i gjendjes së dobëte ekonomike, shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**Për shkak se:**

-Me dt. 11.06.2020 rreth orës 10:20 brenda QKD-se në Istog në bashkëveprim dhe pa autorizim blejnë substancë narkotike të llojit marihuan me qëllim të shpërndarjes në Qendrën e lartcekur, në atë mënyrë që përderisa i akuzuari V ishte në vuajtje të dënimit në burgun e cekur si me lartë përmes telefonit porosit vëllain e tij këtu të akuzuarin A që ti siguron substancë narkotike dhe tramadoll dhe të njëjtat ti sjelle gjatë vizitës në qendër, me ç ‘rast i akuzuari A pasi që i siguron siguron substancat e sipër shënuara të njëjtat i vendos në paketime të vogla të mbështjella me plasmas në një xhakete me ngjyre të kuqe, e duke ja venë në disponim bashkëshorte se të akuzuarit V. V pa dijeninë e saj, kur kjo e fundit në

cilësinë e vizitores ditën kritike dërgon gjësendet për akuzuarit V ku gjate kontrollit nga zyrtaret korrektuese është gjetur substanca narkotike e cila pas ekzaminim nga AKF-ja ka rezultuar se ne 14 paketime te vogla gjenden substanca e llojit marihuan ne peshe prej 1.88 gram, ndërsa dy paketime kane rezultuar me përmbajtja tramadoll me peshe prej 0.46 gram.

**-Me çka ne bashkëkryerje kane kryer vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substanca psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg 2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 275 prg 1 pika 1.8 te KPRK-se.**

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 21,41,42,43,46,49,52,73,74, neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, si dhe neneve 365 të KPPRK-së te akuzuarit i :

## G J Y K O N

1. Të akuzuarin V. S për veprën penale të cekur si më latë i cakton dënim me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënimin me gjobe ne lartësi prej 150 ( një qind e pesëdhjeta e euro ), të cilat dënime do të ekzekutohen më së largu në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmëri se këtij aktgjykimit.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin e gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim burgu duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës.

1. Të akuzuarin A. S për veprën penale të cekur si më latë i cakton dënim me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënimin me gjobe ne lartësi prej 150 ( një qind e pesëdhjeta e euro ), të cilat dënime do të ekzekutohen më së largu në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmëri se këtij aktgjykimit.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin e gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim burgu duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës.

Të akuzuarve u konfiskohet substanca narkotike ne peshe prej 1.88 gram, dhe substanca me përmbajtja tramadoll me peshe prej 0.46 gram, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjtat do të shkatërrohen.

Te akuzuarit secili veç e veç lirohen nga shpenzime e procedurës për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

## II.

### **Për të akuzuarën:**

**3.V. M. S**, e bija e B. dhe nenës L, e gjinisë S e lindur me dt. .... ne M, me banim ne rrugën “K. V” nr. ... ne M, e martuar, ka te kryer shkollën mesme, e pa pune, me numër personal ..... shqiptare, Shtetas i R. së Kosovës, mbrohet ne liri.

Konform nënti 363 par. 1 pika 1.1 te KPPRK-se **REFUZOHET AKTAKUZA**

### **Për shkak se:**

- Me dt. 11.06.2020 rreth orës 10:20 brenda Qendrës korrektuese të ..... K. I në bashkëveprim kanë shpërndarë substanca Narkotike të llojit “Marihuanë” peshë prej 1.88 gram, në atë mënyrë që i pandehuri V i cili ishte në vuajtje të dënimit në B e cekur më lartë, fillimisht përmes telefonit e ka porositur të pandehurin A që brenda në burg dhe gjatë vizitës t’ia sjellë narkotikun, e pastaj i pandehuri A pasi që ka siguruar narkotikun, me të pandehurën V e kanë organizuar mënyrën e dërgimit te i pandehuri V, ashtu që pasi që i pandehuri A nga persona deri më tani të panjohur e ka siguruar narkotikun, të njëjtën e ka vendosur në paketime të mbështjella me plastmas dhe e ka fshehur në një xhaketë me ngjyrë të kuqe, me ç ‘rast ditën kritike kur kanë shkuar për ta vizituar të pandehurin V, e pandehura V e merr xhaketën me narkotikë dhe e vetme ka hyrë për vizitë tek i pandehuri V, ku gjatë kontrollit të xhaketës nga zyrtarët korrektues janë gjetur dhe sekuestruar 16 paketime të vogla, nga të cilat 14 paketime kanë qenë me substancë narkotike të llojit “Marihuanë” me peshë prej 1.88 gram ndërsa dy të tjera kanë ka rezultuar se nuk përmbajnë narkotik të rrezikshëm por Tramadol me peshë prej 0.46 gram,

**Me çka ne bashkëkryerje kishte për të kryer vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substanca psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg 2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 275 prg 1 pika 1.8 te KPRK-se.**

**-Për shkak se prokuroria ka heq dorë nga aktakuza për të akuzuarën V. M. S.**

**Shpenzimet e procedurës në këtë çështje penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.**

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/L.nr.225/20 të dt. 25.11.2020, në lëndën penale kundër të akuzuarve V.S, A. S si dhe e akuzuara V. M. S nga M për shkak te veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substanca psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg 2 lidhur me nenin 275 prg 1 pika 1.8 te KPRK-se.

Gjykata ka mbajte seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe pas administrimit të provave, prokurorja para fjalës përfundimtare ka hjek dore nga aktakuza dhe ndjekja penale për të akuzuarën V. M. S, dhe ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës sa i përket përshkrimin faktik për dy të akuzuarit V dhe A. S si në dispozitivin e parë.

Pas kësaj i akuzuari V. S ka deklaruar se do të deklarohet sërish për fajësinë dhe më këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe i akuzuari ka deklaruar se: pasi që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të

cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë, e pranon fajësinë vullnetarisht pa kurrfarë presioni.

I akuzuari A. S ka deklaruar se do të deklarohet sërish për fajësinë dhe më këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe i akuzuari ka deklaruar se: pasi që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë, e pranon fajësinë vullnetarisht pa kurrfarë presioni.

Me pranimin e fajësisë është pajtuar me pranimin e fajësisë pasi që është bërë në konsultim me mbrojtësit e tyre, të njëjtit e kanë pranuar në të gjitha fazat e procedurës e pjesërisht edhe në shqyrtim gjyqësor, e po ashtu ka mbështetje edhe në shkresat e lëndës

Me pranimin e fajësisë janë pajtuar edhe mbrojtësit e të akuzuarve, pasi që të njëjtit deklaruan se janë konsultuar paraprakisht me të mbrojturit e tyre secili veç e veç..

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarve vlerësoi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni pasi ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Duke pasur parasysh të lartcekurat dhe provat në shkresa të lëndës gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së apo përjashtimin e përgjegjësisë penale, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtarë ka deklaruar se: meqenëse të pandehurit e pranuan fajësinë dhe i cili pranim ka mbështet te plote në shkresat lëndes, u vërtetua se të njëjtit si të bashkëpandehur kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtit të shpalle fajtor të dënojnë sipas ligjit si dhe të obligojnë në paguarjen e shpenzimeve procedurale, e po ashtu konform neni 267 prg. 5 të KPRK-se, substanca narkotike të sekuestruara të konfiskohen dhe të njëjta të urdhërohen për shkatërrim.

Ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimi nga ana e gjykatës si rrethana lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, sjellja korrekte para gjykatës, gjersa si rrethana rënduese fakti se i pandehuri V është dënuar për një veprën penale, si dhe nga evidenca policore të njëjtit janë të njohur për organet e rendit, dhe njëherit shkallën e lart të dashjes për kryerjen e veprës penale.

Mbrojtësit av. Muharrem Shala në fjalën përfundimtare ka deklaruar se : - konsideroi se në bazë të provave materiale të cilat janë të deponuara në shkresat lëndes të gjykatës dhe atë duke u bazuar raportet të hetuesve policor dhe në procesverbalin për dëgjimin nga ana e prokurorit si dhe nga deponimi i klientit tim të dhëna në këtë gjykatë është vërtetuar bindshëm dhe në mënyrë të sigurt se e kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkohen në aktakuzë. Klienti im e ka pranuar fajësinë pa qene në kushteve të presionit, të dhunës, mashtrimit, apo të lajthimit por në baze të vullnetit të shprehur lirisht dhe me vete dijet e plote e ka pranuar fajësinë. Klienti im shkaqe shëndetësore dhe shqetësime tjerë shpirtërore i është nevojitet konsumimi i narkotikeve, mirëpo sasia e narkotike të llojit marihuan është në peshë prej 1.88 gram, ndërsa substanca tjetër sipas mendimit të raportit nuk paraqet rrezikshmëri. Nga këto arsye dhe duke u bazuar në sjelljet e të pandehurit, në qëndrimin e tij korrekt si dhe në pendimin për shkak të kryerjes së kësaj veprë penale të njëjtit të keni parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e matjes dhe përcaktimit të dënimit në këtë çështje juridiko penale.

I akuzuarit V. S ne fjalën përfundimtarë ka deklaruar se: -e mbështet fjalën e mbrojtësit te tij, nuk do ti përsërisë veprime e tilla, dhe as te ndonjë vepër tjetër penale.

Mbrojtësit av. Lulzim Bala ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: -qëndroj pas thënies se i mbrojturi im e ka pranuar veprën penale dhe qëllimi i dënimit është qe ne te ardhmen te ndikoi qe te mos kryej vepra penale. Gjate matjes se dënimit gjykata duhet te ketë parasysh këto rrethana lehtësuese. Si rrethana lehtësues duhet te merret pranimi i fajësisë i cili i mbrojturi im e ka bere ne mënyrë vullnetare, goditja shpirtërore, sjellja e mire gjate gjithë kohës se mbajtjes se gjykimit, gjendje e varfër ekonomike, ku asnjë anëtar i familjes nuk i punon, sasia e vogël e narkotikut, premtimi se i njëjti nuk do te përsërisë këtë vepër penale. Konsideroi se me bindje te plote gjykata duhet ti merr parasysh këto rrethana lehtësuese dhe ti shqiptohet një dënim i arsyeshëm.

I akuzuarit V. S ne fjalën përfundimtarë ka deklaruar se: -e mbështet fjalën e mbrojtësit te tij, duke shtuar se nuk do te përsërisë me.

Gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarve V. S dhe A. S ekzistojnë të gjitha elementët e veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe e shpalli fajtor bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve , dhe provat që gjenden në shkresa të lëndës siç janë: Raporti i oficerit H. N., i dt. 11.06.2020, deklarata e të dyshuarit V. S e dhënë në polici me dt. 08.10.2020, deklarata e shkruar nga i dyshuari V. S. me dt. 11.06.2020, deklarata e të dyshuarës V. M e dhënë në polici me dt. 11.06.2020, Raporti ndaj vizitorit dt. 11.06.2020 i përpiluar nga Zyrtari Korrektues G. K., deklarata e të dyshuarit A. S e dhënë në polici me dt. 11.06.2020, deklarata e të dyshuarës V.M e dhënë në Prokurori me dt. 11.11.2020, deklarata e të dyshuarit A. S të dhënë në Prokurori me dt. 11.11.2020, dëftesa mbi konfiskimin e pronës-Narkotikut dt. 11.06.2020, Raporti mbi ekzaminimin e Narkotikut me nr. AKF/...-.../.....-... i punuar me dt. 15.07.2020, fotografit e narkotikut të sekuestruar, informacionet e siguruar nga Data baza e policisë mbi të kaluarën kriminale të te dyshuarve, si dhe shkresat të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese që ndikojnë në llojin e dënimit. Nga rrethanat lehtësuese gjeti se: te akuzuarit e kanë pranuar fajësinë që në fillim për veprimet e tyre dhe premtimin se nuk do të përsërisin veprime të tilla si dhe gjendjen e dobët ekonomike. Nga rrethanat rënduese gjykata për të akuzuarit V dhe A. S gjeti sjelljen e tyre të mëparshme nga se nga evidenca policore rrjedh se më parë kanë qenë të dyshuar për vepra të ndryshme penale, pastaj faktin se i akuzuari V. S është i dënuar për vepër penale të vrasjes në tentativë, për të akuzuarin A. S si rrethanë rënduese gjykata gjeti shkallen e lartë të përfshirjes, pasi që i njëjti është i përfshirë në vepër penale që nga porositja e substancës narkotike nga i akuzuari V, ku i akuzuari A e siguron substancën narkotike e deri te dërgimi i substancës në Institucion.

Bazuar në rrethanat e cekura më lartë e veçanërisht në pranimin e fajësisë konform nenit 71 dhe 72 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së gjykata ndaj të njëjtëve ka caktuar dënimin me burg nën minimumin e paraparë ligjorë duke pas parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se dënimet e përcaktuara janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që

është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprës penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit u mor bazuar në nenin 267 prg. 5 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin konform nenit 454 par. 1 e akuzuara V. M u lirua nga shpenzimet e procedurës penale, ndërkaq konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së i liroi të akuzuarit V dhe A. S nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, pasi që të njëjtit janë të gjendjes së dobët ekonomike nga se janë shfrytëzues të ndihmës sociale, siç rrjedh nga kartoni social me numër 33766 të dt.04.06.2021, në emër të nënës së të akuzuarve ku është i përfshirë edhe i akuzuari A.

Meqë prokurori ka heq dorë nga aktakuza për të akuzuarën V. M. S gjykata konfrom nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPRK-së e ka refuzuar aktakuzën për të njëjtën.

Për të akuzuarit V dhe A. S gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

**2020:144220, 24.03.2022**

**Kryetarja e trupit gjykues**

\_\_\_\_\_  
Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.